

# Rrethimi i madh i “ciganëve” në Spanjë

Antonio Gómez Alfaro

Një masë sigurie parandaluese | Një rrethanë e favorshme | Strategjia | Financimi i rrethimit | Destinimi i të burgosurve | Rishikimi i rrethimit | Problemet me “ciganët” e liruar | Arsytet për falje | Një vonesë e papritur

► *Epoka e Absolutizmit iluminues iu dha autoriteteve mundësi të mëdha për t’i zbatuar masat e tyre ndaj të gjithë qytetarëve në gamën e tyre të pushtetit. Në Spanjë, kjo rezultoi në episodin më të dhimbshëm në historinë e vendit lidhur me komunitetin “Cigan”: rrethimi i përgjithshëm i kryer gjatë sundimit të Ferdinandit VI, më 30 korrik, 1749. Operacioni, që ishte po aq gjithëpërfshirës sa edhe jo dallues, shpui në internimin e dhjetë deri dymbëdhjetë mijë njerëzve, burra dhe gra, të rinj dhe të vjetër, “thjesht sepse ishin Ciganë.” Koordinimi i autoriteteve të ndryshme publike që u përfshinë, bashkëpunimi i Kishës, që mbeti pasive përballë një padrejtësie të tillë, teprimet e kryera nga të gjithë ata që e bënë operacionin të mundur, bashkëpunimi i qytetarëve dhe fqinjëve të të burgosurve e bënë “të Mërkurën e Zezë”, që ishte një shprehje tjetër për rrethimin, një ngjarje të padiskutueshme në historinë e gjatë të anti-“Ciganësisë” evropiane.*

## NUMRI I FAMILJEVE “CIGANE” ME VENDBANIM


III. 1

Pas një liste nga Këshilli i Kastiljes me gjasë e vitit 1749  
(nga Gómez Alfaro 1993, f. 22f.)

## PARATHËNIE

Gubernatori i emëruar i Këshillit të Kastiljes, në kohën e autoritetit më të lartë politik të monarkisë spanjolle, Gaspar Vázquez Tablada, Peshkop i Oviedos, ia paraqiti një “konsultim” duke propozuar miratimin e “mjeteve të jashtëzakonshme” për t’iu dhënë fund përgjithmonë “problemeve” të rendit publik që gjoja ishin krijuar nga “Ciganët”, Mbretit Ferdinand VI, më 5 korrik, 1747. [III. 2]

“Propozimi” shkurtazi rishikonte masat ligjore të cilat që nga kohët e lashta kishin tentuar të dobësonin tjetërsimin e “Ciganëve”; dështimi i tyre evident ofronte arsyetimin, sipas pikëpamjes së peshkop-gubernatorit, për ndarjen e këtyre personave të pa shndërrueshëm nga trupi i shoqërisë përmes dy






III. 2

Mbreti Ferdinand VI (1746 - 1759)

(nga Sánchez-Albornoz, Claudio (1971) España, un enigma histórico. Buenos Aires: Editorial Sudamericana, f. 560b)



III. 3

Urdhri për rrethimin e “Ciganëve”, i lëshuar nga Gaspar Vázquez Tablada me 28 qershor, 1749 (autoriteteve të Orihuela; faqja e parë).

(nga Gómez Alfaro 1993, f. 17) (Detaj)

mundësive alternative. E para nga këto nënkuptonte dëbimin e tyre të përhershëm nga mbretëria, duke iu caktuar një afat kohor për tu larguar dhe duke iu parashkuar në mënyrë të “pafalshme” dënimet me vdekje të gjithë atyre që ktheheshin, dhe në këtë mënyrë duke eliminuar çdo mundësi për intervenim gjyqësor. Nëse kjo masë e përjashtimit “do të dukej e ashpër“, një masë tjetër më e butë do të zbatohet; kjo masë “më e butë“ përbënte rrethimin e “Ciganëve” dhe gjetjen e një vendi të përshtatshëm për vuajtjen e dënimit të tyre me burg.

Në këtë mënyrë rrethimi u paraqit një hap i pashmangshëm preliminar në

shqiptimin e masave parandaluese të sigurisë ndaj ndonjë grupi anëtarët e të cilit pa dallim konsideroheshin si të rrezikshëm për shoqërinë, nëse jo – së paku disa individë – si kriminel. Pavarësisht nga sjellja e mundshme kriminale që meritonte një dënim specifik, disa të dhëna bashkëkohore vazhdimisht theksojnë ekzistencën e “një koncepti të dytë gjenerik të përtacëve dhe personave të pabindur ndaj ligjeve”, në mesin e “Ciganëve”, “ashtu që, si të tillë, ata duhet të ndahen për shkaqe parandaluese në mënyrë që t’i jepej fund krimeve dhe kotësisë së tyre”.

Për një kohë të gjatë, “Ciganët” kishin vuajtur pasojat e klasifikimit të tyre të

gabuar, duke u shpjeguar nga aspekti i lëvizshmërisë së tyre (mungesës së banimit të përhershëm) dhe nga aspekti i punës në profesionet që ishin të vështira të kategorizoheshin. Fjala “Cigan” përfundimisht u bë një etiketim ligjor që zbatohet për një varg të gjerë të individëve të cilët nuk formonin një grup koherent dhe të bashkuar. Pasi që përgjegjësia për shqetësim civil tradicionalisht bie në ato grupe lëvizshmëria e të cilave pengon kontrollin efektiv shtetëror, shtypja e atyre që përgjithësisht referoheshin si “Ciganë” ishte gati të bëhej qëllimi kryesor i një operacioni policor, në të cilin ushtria në fund u përfshi si një rojë e rendit publik.

## NJË MASË SIGURIE PARANDALUESE

Duke u mbështetur në veçanti në bashkëpunimin e ushtrisë, që ishte bërë esenciale për rrethimin, Guvernatori i Këshillit të Kastiljes, Vázquez Tabla-

da, rekomandoi përgatitjen e një operacioni policor nën kushtet e fshtësisë së plotë, që do të bënte të mundur arrestimin e të gjithë “Ciganëve” në të njëjtën kohë në tërë vendin, “në një ditë të fiksuar dhe të caktuar”. Burgu ishte një fazë preliminare në zbatimin e masave parandaluese të sigurisë që

ndryshonin sipas moshës dhe gjinisë. [III. 3]

“Cigane” femra do të mbahehin në tri “depo”, një përzjerje e burgut, barakave dhe fabrikës, që gjendeshin në lokacionet strategjike, “një për Andaluzi, tjetra për Ekstramadura, la Mancha dhe Murcia, dhe e treta për Kastilje dhe

## URDHRI PËR RRETHIM

Urdhri ishte përgatitur në fshehtësi dhe shpërndarë vetëm në letra të shkruara, shumica e të cilave iu ishin adresuar "corregidor" (gjqtarit senior) të secilit regjion ku "Ciganët" do të arrestoheshin. Çdo familje në secilin qytet ishte paditur ndarazi; "corregidor" ishte bërë përgjegjës për arrestimin e të gjithëve. Originali i paraqitur këtu iu ishte adresuar qytetit të Orihuela. Fjalja e parë ishte:

*"Mbreti (Zoti e ruajt) ka vendosur që katërmbëdhjetë familje Cigane të cilat janë me vendbanim në atë qytet, sipas dekretëve të këshillit do të zhvendosen ..."*

III. 3

(nga Gómez Alfaro 1993, f. 15)



III. 4

*Qethësit ciganë të mushkave në Spanjë, diku rreth vitit 1800, litografi nga Gérard René Villain. Bibliothèque nationale, Paris*

(nga Fraser (1992) Ciganët. Oxford / Cambridge: Blackwell, p. 167)

Mbretëritë e Kurorës së Aragonit, ku më pak nga to jetojnë."

Djemtë deri në moshën 12 vjeçare do të mbeteshin me gratë, ndërsa ata prej moshës 12 deri 15 vjeçare do të vendoseshin në mësimin e zanatit në mënyrë që të fillonin me zanate të "dobishme", ose do t'i besoheshin Marinës nëse tregonin një shkathtësi për aktivitete detare. Të rriturit "Ciganë" prej moshës 15 e më lartë, do të dërgoheshin në arsenalet e Kadizit, Kartagjenës dhe El Ferrol si punëtorë me dhunë për t'i zëvendësuar ata që ishin të punësuar në programet për rindërtimin e marinës që u ndërmorën në këtë periudhë.

"Ciganët" meshkuj përmbi moshën 50 vjeçare do të dërgoheshin në qytetet e mëdha, ku do të mbaheshin nën mbikëqyrje të afërt dhe do të punësoheshin në detyrat që ishin të përshatshme për kushtet e tyre fizike; ata që vuanin nga sëmundjet e pashërueshme, të paafitit dhe të vjetrit do të dërgoheshin në spitale dhe azile "që tu ofrohej përkujdesje dhe të vdisnin një vdekje të krishterë".

## NJË RRETHANË E FAVORSHME

Guvernatori i këshillit ishte i bindur për suksesin e operacionit, duke marrë parasysh kombinimin e dy rrethanave specifike që konsideroheshin si "rrethanë e favorshme".

Rrethana e para kishte të bëjë me mundësitë që ofroheshin përmes dekretit të fundit peshkopal, i cili deri në një shkallë ishte kulmi i një procesi të gjatë të negociatave diplomatike me Papatin e Shenjtë për t'iu heq "Ciganëve" të drejtën për imunitet klerik lokal. Në këtë mënyrë ishte e mundur të neutralizohej çdo rezistencë e mundshme përmes përdorimit të vendeve të shenjta si faltore. Pasi që ambasadori i papës ishte autorizuar të urdhëroj transferin e strehë-kërkuesve në kishat e burgimit, ku ata do të mund të mbanin imunitetin për aq sa nevojitej për procedurën e ankesës që të zgjidhej në mes të gjykatave civile dhe klerike, një dekret tjetër peshkopal u nxor, e që autorizonte ambasadorin e

njëjtë të delegonte pushtetin e tij te peshkopët për sa i përkiste dioqezave të tyre përkatëse.

Faktori i dytë ishin rezultatet pozitive të operacionit të ri-vendosjes që ishte vënë në lëvizje në vitin 1717 përmes një ligji që ishte një azhurnim me disa amendamente të Pragmatika nga Charles II e vitit 1695. Risia e saj kryesore ishte në caktimin e dyzet e një qyteteve si vende të vetme të autorizuara të banimit për "Ciganët". Një dispozitë e vitit 1746 do të shtonte 34 qytete të reja në këtë listë. [Iills. 5, 6]

Këshilli kishte ruajtur kontrollin e centralizuar ndaj operacionit të ri-vendosjes, kështu që i dinte adresat e më tepër se 800 familjeve "Cigane" në 75 qytete ku individët e kësaj kategorie ishin të autorizuar të jetonin. Vázquez Tablada konsideronte se, që të arrihej "efekti i mirë dhe i dëshirueshëm", që do të thoshte rrethimi i "Ciganëve", do të ishte e mjaftueshme tu jepeshin udhëzimet përkatëse autoriteteve të 75 qyteteve ku ata ende duhej të banonin. Shqyrtimi i kujdesshëm i arkivave të



III. 5

Pragmatica e Charles II, e lëshuar me 12 qershor, 1695.

(nga Leblon 1995, f. 34)

## MASAT KARAKTERISTIKE TË PRAGMATICA NGA CHARLES II NË VITIN 1695

Shumë ligje u miratuan për të ndrequr “dështimet” e gjithë legjislativonit të mëhershëm. E para nga këto, e nënshkruar nga Charles II në vitin 1695, urdhëroi të gjithë “Ciganët” të regjistroheshin tek autoritetet e vendbanimit të tyre brenda tridhjetë ditëve. Pas një periudhe prej tridhjetë ditëve tjera, të gjithë “Ciganët” duhej të braktisnin vendin. Profesionit i vetëm i autorizuar për “Ciganët” ishte kultivimi i tokës. Ishte e ndaluar që “Ciganët” të posedonin ose shfrytëzonin kuajt; ata e kishin të ndaluar të posedonin armë të zjarrit; blerja, shitja dhe tregtia e kafshëve të cilitdo lloj ishte e ndaluar. “Ciganët” nuk lejoheshin të jetonin së bashku në të njëjtën lagje, e as të vishnin kostumet që ishin të ndryshme nga ato të

banorëve tjerë, ose të flisnin gjuhën e tyre. Atyre u lejohej të largoheshin nga vendbanimi vetëm për të shkuar të punonin në fushat e tyre dhe nuk kishin të drejtë të udhëtonin në ndonjë vend tjetër pa autorizimin me shkrim nga autoritetet.

Dënimi tipik për ata që nuk bindeshin ishte gjashtë deri tetë vjet në galera (për meshkujt prej shtatëmbëdhjetë deri gjashtëdhjetë vjet) ose 100 deri 200 goditje me kamxhik ose internim (për femrat). Djemtë prej katërmëdhjetë deri shtatëmbëdhjetë vjet dërgoheshin në punë të dhunshme për disa vjet. Mirëpo, për shembull, personat që udhëtonin në grupe prej më tepër se tre veta dhe që mbanin ndonjë armë dënoheshin me vdekje.

III. 6 (shkurtuar nga Leblon 1995, f. 37ff.)

këshillit iu mundësoi zyrtarëve të tij të hartojnë një listë, që ishte baza për punën e strategëve të rrethimit. Kjo listë zbuloi ekzistencën e 881 familjeve të vendosura në 54 nga 75 qytetet, në proporcion të kushtëzuar ligjërisht në dispozitën e vitit 1746: një familje, që nënkuptonte “burrin dhe gruan, me fëmijët e tyre dhe nipat e mbesat jetim, nëse nuk ishin të martuar”, për çdo 100 banorë. Me shpërndarjen e racios prej një familje “Cigane” për njëqind banorë autoritetet do të siguroheshin se ata do të merrnin përgjegjësinë për mbikëqyrjen e mënyrës së jetesës dhe aktiviteteve të këtyre familjeve, duke i kushtuar një kujdes të veçantë ndarjes së tyre nga njëri tjetri. [III. 1]

### STRATEGJIA

Një mendim ishte kërkuar nga Ati Jezuit Francisco Rávago, rrëfyesi i Ferdinandit VI, përgjigja e menjëhershme e të cilit largoi të gjitha dyshimet dhe skrupujt nga vëmendja e tij mbretërore pendestare: “Mënyrat e propozuara nga guvernatori i këshillit për të çrrënjësuar këtë racë të


keqe, që është e urryer nga Zoti dhe e dëmshme për njeriun, mua më duken të mira. Mbreti do t’i bënte një dhuratë të madhe Zotit Tanë, nëse arrin t’i heq qafe këta njerëz.”

Krejt çka mbeti ishte të sajohet një strategji për operacionin, një lëndë që u trajtua në mënyrë shteruese nga Markezi i la Ensenada, forca shtytëse pas të gjitha projekteve të mëdha të ndërmarra gjatë kësaj periudhe. Rrethimi u caktua për 30 korrik, 1749, dhe Ensenada i shikoi nga afër rezultatet fillestare. Këto nuk i pëlqyen dhe, në letrën e datës 12 gusht, ai ia atribuoi dështimet peshkop-guvernatorit “për shkak të pakujdesisë me të cilën lajmi për këtë ndërmarrje është zbuluar”. Vázquez Tablada ishte shkarkuar dy ditë më herët dhe ishte zëvendësuar nga Peshkopi i Barcelonës. Pastaj Ensenada mori tërë përgjegjësinë për operacion dhe lëshoi udhëzime të hollësishme me qëllim të zgjerimit të rrethimit për të “gjithë Ciganët që jetonin në këto mbretëri, pa marrë parasysh nëse kanë banim të përhershëm, pavarësisht nga gjinia, statusi civil dhe moshja, dhe duke mos kursyer ndonjë faltore në të cilën ata mund të kenë gjetur strehim.” [III. 9]

Dokumentacioni në dispozicion tregon se arrestimet shkuan në mënyrë të qetë. Ekzistonte vetëm një dëshmi e incidentit të dhunshëm, kur tre “Ciganë” duke ikur për Sevilë ishin vlarë gjatë një konfrontimi që ndodhi në rrugën për La Cartuja. Vetë “Ciganët”, ndoshta të pavetëdijshëm për qëllimin e vërtetë të arrestimit të tyre, shkuan vullnetarisht në shumë vende si përgjigje ndaj njoftimeve publike që iu kërkonin atyre të raportonin në “corregimiento” (kjo fjalë ka kuptimin e zyrës dhe juridiksionit të “corregidor”).

Lidhur me faltoret në vendet e shenjta, të cilat mund të kishin penguar arrestimet, ishin vetëm disa raste të izoluara që shumë shpejt u zgjidhën.

Për shkak se martesat e përziera ishin një realitet në shumë pjesë të vendit në këtë periudhë të historisë, autoritetet ishin shtyrë të kërkojnë nga këshilli që të caktonte rregullat specifike për vendosjen e fatit të bashkëshortëve jo-“Ciganë” dhe fëmijëve të etnisë së përzier. Këshilli deklaroi që statusi i burrit të jetë mbizotërues, që nënkuptonte se gratë e martuara do të përfshiheshin në kategorinë e njëjtë sikurse burrat e tyre, edhe pse ky parim i përgjithshëm nuk parandalonte



III. 7  
Udhëzimet për "corregidores" (për autoritetet Orihuela, faqja e parë)  
(nga Gómez Alfaro 1993, f. 30) (Detaj)

### UDHËZIMET MË TË HOLLËSISHME

Udhëzimet për "corregidores" kishin për qëllim dhënien e përgjegjeve shumë të detajuara për çfarëdo problemi që do të mund të shfaqej gjatë rrethimit. Duke qenë përgjegjës për hapat preliminar dhe vetë arrestimin, ata shkruan [...]: "Pasi që të gjitha familjet e përmendura të arrestohen, meshkujt duhet të ndahen me djemtë përmbi shtatë vjeç, ndërsa femrat me fëmijët më të vegjël. Kur të kryhet kjo ndarje, së bashku me dëshmitë përkatëse për regjistrimin e emrave, ata duhet t'i dërgohen oficerit kur ai të jetë i gatshëm për marshim, në dy grupe, duke i rregulluar etapat sipas destinimit të tyre, dhe për transportimin e të burgosurve "corregidor" duhet të përgatis vagonët, bagazhin dhe udhëheqësit e nevojshëm".

III. 7  
(nga Gómez Alfaro 1993, f. 28)

vlerën speciale që lidhej me sjelljen e integruar shoqërore. [III. 7]

### FINANCIMI I RRETHIMIT

Udhëzimet e Ensenadas saktësonin se prona e të gjithë të internuarve do të konfiskohej dhe do të vihej në ankand për t'i paguar kostot e shkaktuara – praktikë e zakonshme në Ancien Régime. Zhvillimi i vetëm i ri në rrethim ishte një element i solidaritetit në mënyrën se si të ardhurat nga ankandi ishin përdorur nga "corregidores". Këto para ishin përdorur për të mbuluar kostot më të ndryshme: pagimin e "alguaciles" (policët vartës që i takonin gjyqtarit ose gjykatës) nëpunësve gjyqësor si dhe letrat e zyrës të përdorura nga kjo e fundit për të regjistruar detajet e operacionit. Për më tepër paratë ishin përdorur për pagimin e mbajtjes së të arrestuarve në burg dhe gjatë transferimeve, për marrjen me qira të qerreve dhe shtazëve që përdoreshin për udhëtim, për ndihmën mjekësore të dhënë disa personave gjatë udhëtimit, dhe prangat, zingjirët dhe litarët

e përdorur për kufizimin e tyre që t'iu pamundësohej ikja. Fqinjët merrnin pjesë në ankande të këtij lloji pa treguar skrupullin më të vogël kur ishte në pyetje blerja e pasurisë së të burgosurve me çmime tërheqëse. Pasuria ishte e një vlere të vogël në shumë raste, por e një vlere të konsiderueshme në disa të tjera, siç ishin vendbanimet e pronësuara ose të marra me qira, shtazët që përdoreshin në bujqësi ose mjetet e punës që përdoreshin nga disa farkëtarë, të cilët ishin të njohur si pronarë të tokave.

Disa ankande u ndërpre në përkrah të veprimeve ligjore të paraqitura nga kreditorët e privilegjuar për t'i kthyer paratë ose pronën e tyre. Ky ishte rasti me një urdhër religjioz që mbante pronësinë e tokës në të cilën një familje "Cigane" ka qenë në gjendje të ndërtoj shtëpinë sipas një kontrate mbretërore.

Për më tepër, përdorimi i arrestimit dhe konfiskimit ishin lehtësuar përmes punës së informatorëve, ekzistonte edhe një numër i konsiderueshëm i rasteve ku njerëzit dhe pasuria fshiheshin, përkundër kërcënimeve nga "corregidores" për dënimin e të gjithë atyre që iu ndihmonin "Ciganëve".

### DESTINIMI I TË BURGOSURVE

Fshehtësia me të cilën rrethimi ishte përgatitur, që ishte një faktor pozitiv në aspektin e suksesit të tij si një operacion policor, kishte efekte negative kur ishte në pyetje vendosja se ku do të dërgoheshin të burgosurit; mungesa e infrastrukturave të burgimit për akomodimin e tyre e bëri të nevojshme mbështetjen në improvizim, me të gjitha problemet që kishte. Të përmend vetëm një shembull: përkundër urdhrimit që të gjithë "Ciganët" Andaluzian të dërgoheshin në Malaga dhe përpjekjes për zbatimin e urdhrimit të këshillit nga anëtarët e këshillit të atij qyteti, ishte i nevojshëm pezullimi i transfereve dhe ri-drejtimi i të burgosurve drejt Sevilës për shkak të grumbullimit serioz të njerëzve.

Gjenerali i divizionit administrativ të Valencisë ishte përgjegjës për kryerjen e rrethimit jo vetëm në Mbretërinë e Valencisë por edhe në regjionet e gjera të Kastiljes, siç ishin Mursia, Kuenca, la Alcarria, la Mancha dhe Toledo. Burrat ishin transpor-



III. 8

Markezi i la Ensenada (1743-1746)

(nga Vaca de Osma, José Antonio 1997: Carlos III. Madrid: Ediciones RIALP, f. 255)

Markezi i la Ensenada, si kryeministër, në mënyrë efektive udhëhoqi vendin nga viti 1743 deri në 1746 dhe vazhdoi të luajnte rolin udhëheqës deri sa u shkarkua në vitin 1754. Thuhet se ai dëshironte një atmosferë të qëndrueshme dhe të qetë përreth Spanjës në të cilën vendi do të mund t'i reformonte institucionet e saj. Në vitin 1749 ai personalisht u siguria që operacioni gjithpërfshirës të shpinte tek rezultatet e duhura, që do të thotë “që kjo kategori e njerëzve [“Ciganët”] do të zhdukej”.

## URDHRI PËR KOMPLETIMIN E BURGOSJES SË “CIGANËVE”

Urdhri i Markezit të la Ensenada për të kompletuar burgosjen e “Ciganëve”, të datës 12 Gusht 1749.

“Lartmadhëria e tij tani urdhëron që me të gjitha mjetet, dhe në secilin vend, burgosja e atyre që kanë mbetur duhet të kërkohet dhe ekzekutohet, duke mos kursyer asnjë strehim që ata mund ta kenë shfrytëzuar. [...] Edhe pse unë tanimë iu kam komunikuar këtë gjyqtarëve të përmendur në kushte të ngjashme, tani atyre prapë ju besoj zbatimin më vigjilent dhe të saktë të [...] urdhrit, ashtu që qëllimi të arrihet, e që është aq i rëndësishëm [...] sepse nëse një mangësi më e vogël konfirmohet, ata do të jenë përgjegjës, dhe masa më serioze do të ndërmerren. [...] Gjyqtari i përmendur do të kryej çdo gjë siç është theksuar, saktësisht dhe plotësisht, siç i takon çështjes së kësaj rëndësie [...]”

III. 9

(nga Gómez Alfaro 1993, f. 63ff.)

tuar në kështjellën Alicante dhe gratë në kështjellën Denia, pa asnjë ikje të vetme të burgosurve, sikurse kapiten gjenerali me krenari e theksonte në një raport të mëvonshëm. Pas një kohe të shkurtë, 200 të rritur dhe 40 djem ishin larguar nga Alicante për në arsenalin e Kartagenas, ku autoritetet bënë strehimin e tyre në galera, të cilat ishin të dedikuara për shulicën e dallgës, që shtriheshin në spirancë në port.

Gratë ishin ndarë në mes të kështjellave të Olivas dhe Gandias. Për shkak të dublimit të brigjeve të përfshira, konsiderohej e përshtatshme të mblidheshin prapë në një vend, dhe kjo u bë në një manastir të vjetër jashtë mureve të qytetit të Valencisë, që ishte përdorur si spital për ushtarët gjatë luftërave në fillimit të shekullit.

Arritja e “Ciganëve” në arsenalin e La Carraca (Kadiz) gjithashtu shkaktoi një varg të tërë të problemeve: mungesa e akomodimit të sigurt për të burgosurit dhe për trupat që i ruanin, mungesa e trajnimit të duhur punues për të burgosurit dhe, si rrjedhojë, mungesat e parashikueshme në punë kur, sipas planit, bëhej zëvendësimi i fuqisë punëtore të

lirë. Rebelimet dhe tentimet e përsëritura për të ikur janë një kapitull në vete në këtë histori. Për shkak të bashkëpunimit në mes të burgosurve, ishte e pamundur të përcaktoheshin përgjegjësitë nga hetimet që ata i nënshtroheshin.

RISHIKIMI  
I RRETHIMIT

“Gjëja më e rëndësishme mbetet të bëhet, me fjalë të tjera gjetja e destinitimit të tyre, në mënyrë që dëmi i madh të mënjanohet dhe kjo kategori e njerëzve do të zhduken, nëse ajo është e mundur”, pranoi Markezi i la Ensenada me 7 shtator, 1749 kur urdhëroi krijimin e komitetit përzgjedhës të përbërë nga anëtarët e këshillit për të studiuar disa pika që i konsideronte veçanërisht të rëndësishme lidhur me “Ciganët” e arrestuar në operacionet e fundit polimore.

Nuk dihet nëse Ensenada tani ishte i bindur për nevojën e ndryshimeve korrigjuese ndaj natyrës fillestare jo diskriminuese me të cilën rrethimi ishte konceptuar. E vetmja gjë që ne dimë

me siguri është se ai lëshoi një urdhër lidhur me të burgosurit “Ciganë” ku u mbajt një “ejecutoria”, që do të thotë një gjykim nga gjykata pa mundësi ankese (në këtë rast, Këshilli i Kastiljes) apo një “dispozitë”, që nënkupton një urdhër me shkrim dërguar përfaqësuesve të sistemit të drejtësisë nga këshilli për zbatimin e tij: “Në zonat ku Ciganët dhe familjet e tyre janë të burgosur, të cilët para dekretit për arrestimin e tyre të përgjithshëm posedonin letrat e privileguara ose masat nga këshilli, ose deklaratimet tjera formale që ata nuk janë Ciganë, ata duhet të mbahen dhe shitja e pasurisë së tyre të pezullohet, derisa përmes raporteve të fshehta të zbulohet nëse jetërat e tyre përputhen me deklaratimet e tilla, dhe nga kjo informatë mund të përcaktohet cilët duhet të lirohen nga dekreti i përgjithshëm i përmendur.”

Komiteti përzgjedhës rekomandoi zbatimin e përgjithshëm të këtij rregulli dhe përfundimisht, në një udhëzim të lëshuar me 28 tetor, 1749, pranoi ekzistencën e “Ciganëve” të cilët, “nga lodhja, frika dhe pendimi”, sipas dekretive që rregullonin jetërat e tyre dhe



III. 10  
Carlos III (1759-88)  
(nga Sánchez-Albornoz 1971, kopërtina)

Karlosi III (1759-88), përveç zvogëlimit të fuqisë së tej rritur të urdhrave të manastireve, shfuqizojë legjislacionin goxha të vjetër dhe kufizues dhe kreu një përtëritje infrastrukturore. Ai gjithashtu hyri në histori si mbreti i cili shtrëngoi popullin e Madridit të heqin dorë nga zbrazja e mbeturinave nga dritaret ose, për shembull, prezantoi shtruarjen e Krishllindjeve sipas modelit Neapolitan. Fakti që përfundimisht ai urdhëroi lirimin e "Ciganëve" nga internimi është praktikisht i panjohur për publikun.

#### "VASALËT TUAJ MË TË PAFAT ..."

Një ankesë nga Bernardo Martínez de Malla, Cristóbal Bermúdez, Miguel Correa, Salvador Bautista dhe Pedro González, romë të burgosur në arsenalin e Kartagjenës, thotë:

"Zotëri, Kastilianët e rinj, të cilët janë burgosur në arsenalin e Kartagjenës përkulen para këmbëve të Lartmadhërisë Tuaj. [...] Ata me përulje i përgjeronen Lartmadhërisë Tuaj që me mëshirë t'i shqyrtojë lutjet e tyre të përulura, dhe tu dhurojë lirinë ashtu që ata ta largojnë pasurinë e tyre të braktisur; dhe t'i bashkohen grave, fëmijëve dhe familjeve të shkreta, të cilat njëjtë janë duke vuajtur për ndarjen nga njëri tjetri, duke pasur nga natyra dhe dashuria lidhje aq të afërta si të gjakut dhe martesës: Vasalët tuaj më të pafat me respekt shpresojnë për mëshirën bujare mbretërore të Lartmadhërisë Tuaj [...]."

III. 11  
(nga Gómez Alfaro 1993, f. 101)

si pasojë "asnjëherë nuk kanë mund dhe nuk është dashur të përfshihen në atë vendim mbretëror sepse duke qenë të pafajshëm ata lirohen nga çfarëdo akuze dhe dënimi." Hapja e dosjeve sekrete u urdhërua (dosjet e hartuara pa pjesëmarrjen e atyre që ishin të përfshirë), dhe nga kjo kohë e më tej dy klasa të "Ciganëve" zyrtarisht u dalluan: "Ciganët e mirë", të cilët ligjërisht ishin martuar, mbanin aktgjykimet ose urdhrat që i shpallnin ata jo-"Ciganë", dhe ishin qytetarë që i bindeshin ligjit; "Ciganët e këqij", të cilët quheshin me një varg të epiteteve: "delikuent", "fajtor", "të pabindur", "ofendues", "të dëmshëm" dhe "të papajtueshëm". Madje edhe nëse i kishin letrat e privilegjit, deklarimet ose masat nga këshilli, ata dënoheshin me punë të dhunshme dhe cakttoheshin në punë publike, dhe nëse ikin, ata do të dërgoheshin në trekëmbësh për varje pa ndonjë mundësi për ankesë. Mirëpo, kjo gjuhë e përciptë ligjore u pasua me zbatim më të butë, sipas raporteve pasuese nga autoritetet përkatëse që ndjenin se tentimet për të ikur madje mund të konsideroheshin "të falshme" nga ana e njerëzve që nuk ishin në dijeni.

#### PROBLEMET ME "CIGANËT" E LIRUAR

Duke shprehur keqardhje që udhëzimi mbretëror nuk parashikonte ndonjë mekanizëm kontrollues lidhur me çështjet që ishin në juridiksionin e vetëm të autoriteteve ndërmjetësuese, një raport i Kontit të Campomanes në vitin 1764 theksonte se, pas liritimit të atyre që ishin burgosur në vitin 1749, "mbretëria gjeti veten me gati po aq "Ciganë" sa më parë".

Pasi që një urdhër ishte lëshuar me kuptimin se pasuria e konfiskuar duhet t'i kthehej "Ciganëve" që ktheheshin në shtëpitë e tyre, ndodhën një numër i incidenteve për të cilat "corregidores" gjetën zgjidhje të ndryshme në secilin rast. Zgjidhja më e shpeshtë ishte të zbriteshin shumat e arritura në ankande dhe të gjitha shpenzimet e shkaktuara, dhe pastaj tu ndahej shumata e mbetur, nëse mbetej diçka, "Ciganëve" të liruar, të cilët pranuan bilancin pa shkaktuar ndonjë problem.

Ata "Ciganë" të cilët nuk kishin arritur t'i tejkalojnë pengesat e paraqi-

tura nga dosjet e fshehta i dërguan një numër të ankesave këshillit nga arsenalin në të cilat ata ende ishin të internuar. Nga viti 1757 e më tej, të gjitha ankesat nuk u pranuan më, dhe në këtë mënyrë të burgosurit e pafat i humbën të gjitha shpresat. [III. 11]

#### ARSYET PËR FALJE

"Ciganët" e burgosur në arsenalin e La Carraca (Kadiz) u dërguan në arsenalin e El Ferrol (Galicia) përgjatë detit në vitin 1752. Ata arritën të shkatërruar për shkak të një epidemie që ishte përhapur në anije gjatë këtij udhëtimit të paparashikueshëm. Gjatë viteve, situata e të mbijetuarve u bë një faktor vendimtar në dhënien e amnistisë, që i dhanë fund operacionit policor të dizajnuar për eliminimin e komunitet "Cigan" spanjoll në vitin 1749. Me 12 gusht, 1762, autoritetet e El Ferrol i dërguan një letër Ministrisë së Marinës përmes së cilës sugjeronin lirimin e një numri të "Ciganëve" "të vjetër, të gjymtuar dhe shëndetligë" dhe endacakëve "të cilët,

absolutisht të paaftë për ndonjë punë, janë vazhdimisht në spital dhe rrisin shpenzimet e mbajtjes dhe trajtimit të tyre pa dhënë ndonjë rezultat”.

Fillimisht, dukej se ministria do ta pranonte propozimin dhe kërkoi për numra në mënyrë që të bëheshin vlerësimet; kërkesa e njëjtë u ishte bërë edhe autoriteteve përgjegjëse për dy arsenalet tjera në Kartagenë dhe La Carraca. Kështu, në Madrid u konstatua se përfituesit e mundshëm të faljes formonin një grup prej 165 individëve, puna e dhunshme e të cilëve nuk ishte më fitimprurëse në shumicën e rasteve.

Me 16 qershor, 1763, Ministri i Marinës i dërgoi një memorandum të shkurtë guvernatorit të këshillit duke deklaruar se Mbreti Charles III, i cili mori fronin në vitin 1759 dhe që ishte gjysmë-vëllai i Ferdinandit VI, kishte vendosur t'i falte të gjithë "Ciganët" të cilët ishin në arsenalet si rezultat i rrethimit të vitit 1749. Bashkëngjitur në memorandum ishin listat e "Ciganëve" të përpiluara nga arsenalet, në të cilat shkruhej se këshilli duhej të specifikonte vendet ku do të jetonin këta njerëz.

### NJË VONESË E PAPRITUR

Mirëpo, gëzimi efektiv i faljes u shty për edhe dy vite për shkak se këshilli u pajtua me sugjerimin e prokurorëve, të cilët shkuan përtej kompetencave të tyre. Ata mendonin se liria për të internuarit duhej të ishte pjesë e një serie të tërë të masave për rregullimin e jetës së të gjithë "Ciganëve" dhe, për atë qëllim, filloi një studim shterës i këtij problemi. Vonesa nxiti ankesa të menjëhershme nga ata të cilët ishin të bindur se fundi i problemeve të tyre ishte i pashmangshëm. Ishte vetë Mbreti Charles III i cili i dha fund kësaj procedure, duke urdhëruar që "Ciganët" të liroheshin pa ndonjë vonesë të mëtejme. Ata u liruan në mes të korrikut 1765, gjashtëmbëdhjetë vjet pasi që rrethimi kishte filluar.

Burgimi zgjati edhe më tepër për një grup të meshkujve, të cilët Brigadieri Diego de Cárderas, Guvernator i Puerto de Santa María, i kishte internuar në vitin 1745. Individët më të fuqishëm u dënuan me punë të dhunshme në minierat e Almadén dhe ata më të dobët u dërguan në kolonitë penale të Afrikës, për

një periudhë katër vjeçare. Fatkeqësisht, përmushja e dënimeve të tyre rastisi me periudhën kur komuniteti "Ciganë" po përjetonte pasojat më të këqija të rrethimit të përgjithshëm. Këshilli vendosi në pajtim me ligjin t'i përfshinte këta meshkuj në mesin e "Ciganëve të këqij", duke iu mohuar mundësinë e hetimit të fshehtë të ngjashëm me ato të kryera ndaj të gjithë të burgosurve të vitit 1749. Mirëpo, në vitin 1762, ata arritën ta shpallin situatën e tyre në një mënyrë të krahasueshme me atë të "Ciganëve" që ishin ende në arsenalet, dhe kështu u bënë përfitues të amnistisë.

Pas një kohe të shkurtë, mbreti autorizoi vazhdimin e procedurës së filluar nga prokurorët e këshillit, të cilët hartuan dispozitat e hollësishme për zgjidhjen e "problemit" social të shkaktuar nga "Ciganët". Këto ishin përfshirë në një projektligj. Një nga nenet përmend masat e ndërmarra për qëllimin e njëjtë gjatë sundimit të Ferdinandit VI, paraardhësit të drejtpërdrejtë të Charles III. Ky i fundit kërkoi nga këshilltarët e tij të heqin atë referencë, duke thënë se ajo çka ishte bërë në këtë kohë "nuk i bënte nderim kujtimit të vëllait të tij të dashur".

### PËRFUNDIM

Për komunitetin "Ciganë" spanjoll, nuk ka nevojë të përmendet se rrethimi kishte pasojat shkatërrimtare. Me mijëra romë të dëbuar, internuar, nënshtruar punës së dhunshme,

dënuar, lënduar dhe vrarë, strukturat e brendshme të komunitetit kishin ndryshuar tërësisht. Një pasqyrë të qartë të ndryshimit jep gjuha "Caló" e romëve spanjoll: brenda disa dekadave pas rrethimit kjo gjuhë përfundoi si një përzierje e gjuhës Romani dhe

Kastiliane. Prandaj, jo vetëm individët dhe familjet por i tërë komuniteti romë i Spanjës nuk arriti të rimarr veten nga lëndimet që pësuan nga agjentët e Epokës së errët të Iluminizmit.

### Bibliografia

**Gómez Alfaro, Antonio (1992)** *El expediente general de gitanos. Madrid: Editorial de la Universidad Complutense* | **Gómez Alfaro, Antonio (1993)** *The Great Gypsy Round-up. Spain: the general imprisonment of Gypsies in 1749. Madrid: Editorial Presencia Gitana* | **Leblon, Bernard (1985)** *Les gitans d'Espagne. Le prix de la différence. Paris: Presses universitaires de France* | **Leblon, Bernard (1995)** *Gypsies and Flamenco. The emergence of the art of flamenco in Andalusia. Hatfield: University of Hertfordshire Press* | **Sánchez Ortega, Helena (1977)** *Los gitanos españoles. El periodo borbónico. Madrid: Castelleto*

